

DREJTUAR:
KËSHILLIT MËSIMOR – SHKENCOR TË FAKULTETIT PEDAGOGJIK

RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES

Për zgjedhjen - rizgjedhjen e një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Menaxhimi në arsim dhe Didaktikë (5.03.00.07, 5.03.00.02 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit);

Në bazë të nenit 1 të Vendimit për formimin e Komisionit recensues me nr. 24-1812/1 të datës 20.11.2025 nga Këshilli mësimor - shkencor i Fakultetit Pedagogjik në përbërje:

1. **Prof. Dr. Fadbi Osmani (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit të Tetovës (në pension)**
2. **Prof. Dr. Dobri Petrovski (anëtar) - profesor ordinar në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit “Kliment Ohridski” -Manastir (në pension);**
3. **Prof. Dr. Metodija Stojanovski (anëtar) - profesor ordinar në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit “Kliment Ohridski” -Manastir (në pension).**

Në lidhje me Konkursin e datës 12.11.2025 në gazetën “Koha”, “Слободен печат” dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës (www.unite.edu.mk/konkurse) për zgjedhje - rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore - shkencore në lëmin Menaxhimi në arsim dhe Didaktikë (5.03.00.07, 5.03.00.02 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), Komisioni recensues pas shqyrtimit të dokumentacionit për aplikim, konstatoi se është paraqitur një kandidat:

Prof. Dr. Lulzim Mehmedi, i lindur më 02.07.1972 në Kërçovë, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me numër aplikimi 04-02-24 të datës 17.11.2025.

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të materialit të Konkursit, titullit të lartpërmendur ia paraqet këtë përshkrim:

1. Të dhëna biografike për kandidatin

Prof. Dr. Lulzim Mehmedi ka lindur më 02.07.1972 në Kërçovë. Shkollën fillore e ka mbaruar në Kërçovë gjatë viteve 1978-1986, ndërsa shkollën e mesme (gjimnazin) e mbaroi po në Kërçovë në periudhën 1986-1990.

Studimet i përfundoi fillimisht në Akademinë Pedagogjike në periudhën 1990-1992, programi studimor Mësim Klasor, ndërsa me themelimin e Fakultetit Pedagogjik u regjistrua dhe në periudhën 1996-1998 përfundoi edhe studimet në programin studimor Mësim Klasor në Fakultetin Pedagogjik “Shën Klimenti i Ohrit”-Shkup. Studimet e ciklit të dytë i përfundoi duke mbrojtur me sukses temën e magjistraturës: “*Drejtori si faktor për institucionalizimin e inovacioneve në shkollë*” në Institutin e Pedagogjisë të Fakultetit Filozofik, të Universitetit “Shën Qirili dhe Metodi”-Shkup, nga 2006 – 2010 në Programin

studimor Menaxhimi në arsim.

Në vitin 2012 është regjistruar në studimet e doktoraturës në Institutin e Pedagogjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit “Shën Qirili dhe Metodi”-Shkup, në programin studimor Menaxhimi në arsim, të cilat i përfundoi duke e mbojtur me sukses temën e doktoraturës “*Struktura organizative dhe udhëheqja në kontekst të trajnimeve për sipërmarrësi në shkollat e mesme*”, në shkurt të vitit 2015.

Nga viti akademik 2010/11 ka qenë i angazhuar si *Bashkëpunëtor i jashtëm* në Fakultetin Filozofik në programin studimor: Pedagogji, në drejtimet: Mësim Klasor, Pedagogji Profesionale dhe Edukim Special dhe Rehabilitim.

Në vitin 2016 punësohet në Fakultetin Pedagogjik dhe zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore Docent në fushën Arsimimi i mësimdhënësve (vendimi nr. 04-05/1, data 15.10.2016), ndërsa në vitin 2021 zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore Profesor inordinar në fushën Arsimimi i mësimdhënësve (vendimi nr. 24-465/1, data 04.06.2021).

Në vitin 2017 zgjidhet ushtrues detyre i programeve studimore Pedagogji Profesionale, Mësim Klasor dhe Drejtimi Parashkollor, ndërsa nga viti 2018 ushtron detyrën e Udhëheqësit të programit studimor Mësim Klasor dhe Drejtimi Parashkollor në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit të Tetovës. Nga viti 2018 ushtron edhe detyrën e anëtarit të senatit si përfaqësues i zgjedhur nga Fakulteti Pedagogjik i Universitetit të Tetovës.

Nga viti 2021 ka ushtruar disa funksione me rëndësi siç janë:

- U.d. Dekan i Fakultetit Pedagogjik (30.09.2021-30.03.2022), (Vendimi numër 04-3464/1 të datës 30.09.2021);
- Dekan i Fakultetit Pedagogjik (27.05.2022-27.05.2025) (Vendim për zgjedhje të Dekanit të Fakultetit Pedagogjik nr.02-1574/1 të datës 27.05.2022);
- Anëtar i Senatit të Universitetit të Tetovës nga radhët e mësimdhënësve të Fakultetit Pedagogjik, prej 20.05.2021 deri në 27.05.2022.
- Anëtar i Komisionit për dhënien e provimit për shkollat fillore, shkollat e mesme dhe universiteteve publike të qytetarëve për mësim gjatë tërë jetës (Vendimi nr. 02-484/1 të datës 20.11.2024)
- Anëtar i Komisionit për hartimin e programeve të reja mësimore nga kl.I-V të arsimit fillor nëntëvjeçar në lëndën Shkencat Natyrore (Vendimi nr.02-213/1 të datës 29.03.2021);
- Anëtar i Këshillit drejtues për ndjekjen e projektit “Përmirësimi i cilësisë në arsim” - NEAR/SKP/2021/EA-RP/0053 (Vendimi nr. 11-548/1 të datës 14.01.2022)
- Anëtar i Grupit konsultues-punues në kuadër të Projektit për përmirësimin e shërbimeve sociale (Vendimi nr. 10-8279/1 të datës 19.12.2024)

Nga 27.05.2025 zgjidhet në mandatin e dytë për Dekan të Fakultetit Pedagogjik, të Universitetit të Tetovës, funksion të cilin e ushtron edhe aktualisht. (Vendim për vërtetimin e vendimit të zgjedhjes së Dekanit të Fakultetit Pedagogjik 02-675/1 të datës 06.05.2025);

2. Të dhëna për veprimtarinë mësimore – arsimore (2021-2025)

Kandidati Prof. dr. Lulzim Mehmedi në vitin 2016 zgjidhet në thirrjen mësimore-shkenocore Docent në fushën e *Arsimit të mësimdhënësve* (vendimi nr. 04-05/1, data 15.10.2016), ndërsa në vitin 2021 zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore Profesor inordinar në fushën e *Arsimit të mësimdhënësve* (vendimi nr. 24-465/1, data 04.06.2021), dhe me sukses ka realizuar lëndët Menaxhimi në arsim, TIK-u në mësimdhënie, Bashkëpunimi midis familjes dhe institucioneve edukativo-arsimore, Pedagogji dhe Didaktikë me studentët e disa programeve studimore në Fakultetin Pedagogjik dhe studentët e drejtimeve arsimore në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore të Universitetit të Tetovës.

Gjithashtu ka realizuar lëndët në ciklin e dytë të studimeve: *Metodologjia e hulumtimeve shkencore dhe Udhëheqja me shkollën* në programin studimor Pedagogji në drejtimin Menaxhimi në arsim, lëndën Ndërmarrësia në arsim në Programin studimor Pedagogji drejtimi Inovacione në mësim dhe programin studimor Pedagogji sociale, si dhe lëndën Pedagogji me Didaktikë në Programin studimor Fizikë arsimore në FSHMN, ndërsa në ciklin e tretë lëndën *Modelimi i procesit edukativo-arsimor*.

Në vitet akademike 2021/22, 2022/23, 2023/24, 2024/25 dhe 2025/26 është angazhuar si bashkëpunëtor i jashtëm në Fakultetin Pedagogjik “Shën Klimenti i Ohrit” - Shkup dhe ka realizuar lëndën *Didaktikë*.

Në këtë periudhë kohore (2021-2025) kandidati Prof. dr. Lulzim Mehmedi ka realizuar me sukses disa vizita akademike jashtë vendit, edhe atë:

1. Pjesëmarrës në trajnimin “A pandemic reality check - Preparing schools for the new normal learning environment” në Institutin Nacional të Edukimit në Singapor, prej 12-15.07.2022. (Confirmation Letter dhe Certifikatë për pjesëmarrje);

2. Vizita Akademike në Sarajevë prej 14-19.11.2021, në Vjenë, Austri prej 26-30.09.2022 në vitin 2022, në Varshavë, Poloni prej 23-28.10.2023 nën organizim të Qendrës për Bashkëpunim Ballkanik Loja. (Confirmation Letters);

3. Vizitë akademike në Northern Illinois University, në Kolegjin e Edukimit, prej 6-14.09.2024 (Invitation Letter dhe Certifikatë për pjesëmarrje)

4. Pjesëmarrës në Trajnimin “Towards Practices and Positives Behavior Support in Education and Social Work Countries Reports - Project ID: 22330002, prej 08-12.09.2025 (Certifikatë për pjesëmarrje)

Në këtë periudhë kohore, ka udhëhequr studentë të ciklit të parë dhe të dytë në Fakultetin Pedagogjik drejt mbrojtjes së temave të tyre të diplomës dhe të magjistraturës dhe ka marrë pjesë në komisionet për vlerësimin dhe mbrojtjen e doktoraturës së 3 kandidatëve.

Po ashtu ka marrë pjesë në realizimin e trajnimeve për zhvillim dhe avancim të kompetencave profesionale të kuadrit edukativo-arsimor dhe shërbimit profesional në shkollat fillore të RMV në kuadër të realizimit të programeve të akredituara nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit përgjat viteve 2021, 2022, 2023 dhe 2024, edhe atë me Këshillin e Europës, Universitetin e Tetovës, Fondacionin për iniciativa arsimore dhe kulturore Hap pas Hapi - Shkup, Qendrën Maqedonase për Bashkëpunim Qytetar dhe CES Academy (Certifikata të lëshuara nga CES Academy dhe Vërtetimi i datës 12.11.2025, Universiteti i Tetovës), edhe atë:

- “Arsimi në kontekst bashkëkohor: Zhvillimi i shkathtësive socio-emocionale”, SHF “Sande Shterjoski”-Kërçovë, 18-19.06.2024, Universiteti i Tetovës (raport nga trajnimi dhe vërtetim)
- “Arsimi në kontekst bashkëkohor: Zhvillimi i shkathtësive socio-emocionale”, SHF “Nuri Mazari”-Dellogozhdë, 20-21.06.2024, Universiteti i Tetovës (raport nga trajnimi dhe vërtetim)

- “Arsimi në kontekst bashkëkohor: Zhvillimi i shkathtësive socio-emocionale”, SHF “Orhan Xhemali”-Tatesh i Epërm, 20-21.06.2024, Universiteti i Tetovës (raport nga trajnimi dhe vërtetimi)
- “Arsimi në kontekst bashkëkohor: Zhvillimi i shkathtësive socio-emocionale”, SHF “Bratstvo”-Ohër, 08-09.07.2024, Universiteti i Tetovës (raport nga trajnimi dhe vërtetimi)
- Trajnim i parë mbi vlerat në kuadër të Projektit Arsim cilësor për të gjithë Maqedonia e Veriut, realizuar në Strugë më 01-02.02.2024, Këshilli i Europës (raport nga trajnimi dhe kontratë)
- Mentorim i parë i shkollave në Strugë në kuadër të Projektit Arsim cilësor për të gjithë Maqedonia, më 16.04.2024, Këshilli i Europës (raport nga trajnimi dhe kontratë)
- Mentorim i parë i shkollave në Tetovë në kuadër të Projektit Arsim cilësor për të gjithë Maqedonia, më 18.04.2024, Këshilli i Europës (raport nga trajnimi dhe kontratë)
- Mentorim i parë i shkollave në Gostivar në kuadër të Projektit Arsim cilësor për të gjithë Maqedonia, më 19.04.2024, Këshilli i Europës (raport nga trajnimi dhe kontratë)
- Trajnim i dytë mbi Zbatimin e kompetencave demokratike në praktikën shkollore në kuadër të Projektit Arsim cilësor për të gjithë Maqedonia e Veriut, realizuar në Strugë më 11-12.06.2024, Këshilli i Europës (raport nga trajnimi dhe kontratë)
- Mentorim i dytë i shkollave në Strugë në kuadër të Projektit Arsim cilësor për të gjithë Maqedonia, më 22.08.2024, Këshilli i Europës (raport nga trajnimi dhe kontratë)
- Mentorim i dytë i shkollave në Tetovë në kuadër të Projektit Arsim cilësor për të gjithë Maqedonia, më 30.08.2024, Këshilli i Europës (raport nga trajnimi dhe kontratë)
- Mentorim i dytë i shkollave në Gostivar në kuadër të Projektit Arsim cilësor për të gjithë Maqedonia, më 23.08.2024, Këshilli i Europës (raport nga trajnimi dhe kontratë)
- Trajnim i tretë online mbi Zbatimin e kompetencave demokratike në praktikën shkollore në kuadër të Projektit Arsim cilësor për të gjithë Maqedonia e Veriut, realizuar në Strugë më 11-12.12.2024, Këshilli i Europës (raport nga trajnimi dhe kontratë)
- Trajnim i katërt online mbi Zbatimin e kompetencave demokratike në praktikën shkollore në kuadër të Projektit Arsim cilësor për të gjithë Maqedonia e Veriut, realizuar në Strugë më 11-26.02.2025, Këshilli i Europës (raport nga trajnimi dhe kontratë)
- Mentorim i tretë i shkollave në Strugë në kuadër të Projektit Arsim cilësor për të gjithë Maqedonia, më 14.03.2025, Këshilli i Europës (raport nga trajnimi dhe kontratë)
- Mentorim i tretë i shkollave në Tetovë në kuadër të Projektit Arsim cilësor për të gjithë Maqedonia, më 18.03.2025, Këshilli i Europës (raport nga trajnimi dhe kontratë)
- Mentorim i tretë i shkollave në Gostivar në kuadër të Projektit Arsim cilësor për të gjithë Maqedonia, më 19.03.2025, Këshilli i Europës (raport nga trajnimi dhe kontratë)
- Trajnim në temë Zbatimi i qasjeve inovative interaktive në të mësuarit, SHF “Naim Frashëri” - Tetovë, 24,25, 26, 27, 28.06.2024 dhe 01.07.2024, CES Academy (raport nga trajnimi dhe certifikatë)
- Trajnim në temë Nxënia përmes hulumtimit, punës me projekte dhe zgjidhjes së problemeve, SHF “Bratstvo-Migjeni” - Tetovë, 05-06.07.2023, CES Academy (raport nga trajnimi dhe certifikatë)
- Trajnim në temë Zbatimi i qasjeve inovative interaktive në të mësuarit, SHF “Bashkimi-Edinstvo” - Gostivar, 20, 21, 22, 23.06.2023, CES Academy (raport nga trajnimi dhe certifikatë)

- Trajnim në temë: Përforcimi i kapaciteteve të drejtorëve të shkollave për ndërtimin e kulturës inkluzive shkollore, trajnim me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme, Shkup, 09.05.2022, Step by Step dhe Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar. (raport nga trajnimi dhe kontratë)
- Trajnim me drejtorët e shkollave fillore: Përforcimi i kapaciteteve të drejtorëve të shkollave për ndërtimin e kulturës inkluzive shkollore, Dojran 01-02.10.2021, Step by step. (raport nga trajnimi dhe kontratë)
- Trajnim bazik dhe i avancuar me studentët e Fakultetit Pedagogjik në temë “Dhuna dhe diskriminimi në shkolla” në kuadër të projektit Promovimi i mjediseve të sigurta shkollore, 27.12.2024 dhe 04.04.2025 (raport nga trajnimi dhe certifikatë)

Kandidati, ka recensuar disa libra universitar siç janë :

1. Arbëresha Zenki-Dalipi, Makfirete Ameti: Metodika e mësimi bashkëkohor të shkrim-leximit fillestar në ciklin e parë zhvillimor II, Universiteti i Tetovës, Vendimi i KMSH të Fakultetit Pedagogjik, nr.
2. Dean Iliev, Didaktika për prindër, Kiro Dandaro, 2021.

Kontributin profesional e jep edhe në pjesëmarrjen në shoqata profesionale siç janë Shoqata e Pedagogëve Shqiptar të Maqedonisë.

Kandidati zotëron cilësi dhe aftësi në fushën e mësimdhënies, të cilat e bëjnë procesin mësimor të qasshëm, interaktiv dhe të kuptueshëm për të gjithë studentët, pavarësisht stilit individual të të nxëniet dhe karakterizohet nga përkushtimi i lartë profesional si dhe me aftësi për të ndërtuar një ambient mbështetës e inkurajues për studentët duke dhënë një kontribut në zhvillimin akademik të studentëve.

2. Të dhëna për veprimtarinë kërkimore -shkencore (2021-2025)

Veprimtaria shkencore dhe hulumtuese e Prof. dr. Lulzim Mehmedi është e përqëndruar në fushën e Menaxhimit në arsim dhe Didaktikës ku ka dhënë një kontribut të rëndësishëm përmes realizimit të një sërë hulumtimesh dhe punimesh shkencore.

Kandidati ka publikuar doracakun “Mjedisi i sigurt shkollor në kurrikulat e Fakulteteve Pedagogjike - model me zgjidhje teorike dhe praktike“, QMEQ, Shkup, 2025 COBISS.MK-ID 66331397, botuar nga Shtëpia botuese Arberia Design, Tetovë, në bashkautorësi me Prof.dr. Dean Iliev dhe Prof. dr.Kiril Barbareev.

Kandidati Prof. dr. Lulzim Mehmedi ka publikuar këto punime shkencore:

1. **Lulzim Mehmedi**, Besa Havziu-Ismaili, Makfirete Ameti: The Impact of School Management on Teacher job satisfaction: a comprehensive study, Education Vol. 7 | No. 13-14, 2025, Pages: 100 – 109, 2025
2. Farizi F., Osmani Q., Iliev D., **Mehmedi L.**: The Reflective Teacher and the Social Competences of Students in North Macedonia, Pakistan Journal of Life and Social Sciences <https://doi.org/10.57239/PJLSS-2025-23.1.00547> Pak. j. life soc. Sci. (2025), 23(1): 7016-7027 E-ISSN: 2221-7630;P-ISSN: 1727-4915, 2025
3. Valdeta Zenuni-Idrizi, **Lulzim Mehmedi**: The school Principal as a Leader and Manager of Pedagogical Activities in School, International Congress on social, humanities, administrative and educational sciences in a changing world/proceedings book, DOI:<https://doi.org/10.30456/19023.978-8605-0-4.2025.09>. ISBN: 978-9952-8605-0-4

4. Besa Havziu-Ismaili, **Lulzim Mehmedi**: The impact of direct teacher-student discussion on the development of social and interpersonal skills in classroom, Pioneer and Academic Studies in Educational Sciences, ICCAR 2025.
5. Flutura Gagic Rexhepi, Rreze Kryeziu Breznica, **Lulzim Mehmedi**, Burhan Reshat Rexhepi: The Role of the Director in the Process of Evaluating School Performance, Pegem Journal of Education and Instruction, Vol. 14, No. 2 , 2024 (pp. 347-355), Scientific Herald of Uzhhorod University. Series "Physics" ISSN 2415-8038 e-ISSN 2786-6688, 2024
6. Flutura Gagic Rexhepi, Rreze Kryeziu Breznica, Besa Luzha, **Lulzim Mehmedi**: Multimedia tools integration in the musical education teaching process, [Issue 55, 2024](#), Received 25.10.2023, Revised 03.02.2024, Accepted 10.03.2024, <https://doi.org/10.54919/physics/55.2024.285wo5>, Scientific Herald of Uzhhorod University. Series "Physics", ISSN 2415-8038 e-ISSN 2786-6688, 2024
7. Flutura Gagic Rexhepi, Rreze Kryeziu Breznica, Besa Luzha, **Lulzim Mehmedi**: Key historical periods in the development of music pedagogy: Analysis and overview, Scientific Herald of Uzhhorod University. Series "Physics", ISSN 2415-8038 e-ISSN 2786-6688, 2024
8. **Lulzim MEHMEDI**, Besa HAVZIU ISMAILI, Makfirete AMETI: The impact of the principals leadership style in teacher performance on the primary education, Education – Journal of Educational Research, Vol. 6|No. 11-12, 2024, Pages: 65 – 71, 2024
9. Arta HALILI, **Lulzim MEHMEDI**: Effective management of changes in primary schools, Vol. 6|No. 11-12, 2024, Pages: 77 – 81, 2024
10. Besa Havziu-ismaili, Aneta Barakoska, **Lulzim Mehmedi**, Teuta Ramadani-Rasimi: [Learning Through Games and Its Impact on the Development of Student's Knowledge During the Pandemic Period](#), International Journal of Cognitive Research in Science Engineering and Education (IJCRSEE), 11 (2), 311-319, 2023
11. **Lulzim Mehmedi**, Makfirete Ameti: The principal as Creator of the School Climate, Education – Journal of Educational Research, Vol. 5|No. 9-10, 2024, Pages: 110-116, 2023
12. Teuta Jusufi, **Lulzim Mehmedi**: The teacher's professional ethic, a factor that affects the success of the student's achievements, Education, Vol . 5 / No . 9 - 10 , ISSN : 2671-3268 (Print), ISSN: 2671-3276 (Online), 2023
13. Teuta Iljazi, Mahir Mustafa, **Lulzim Mehmedi**: The effects of evaluation of the Special Study Week/SSW 2022 – a case study of the Faculty of Pedagogy at University of Tetova, Pioneer and Academic Studies in Educational Sciences, Publisher's Certification Number: 72273, ISBN: 978-625-5900-61-6, www.allsciencesacademy.com, 2023
14. **Lulzim Mehmedi**, Gzim Xhambazi: Integration of foreigners within the boundaries of the European Union: national states and citizenship, Freedom - Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication, Volume 3. Issue 5/6, ISSN: 2671-3404 (Print), ISSN: 2671-3411 (Online), 2022
15. **Lulzim Mehmedi**, Makfirete Ameti: Forms and methods of school - family cooperation, Education, Vol . 4 / No . 7 - 8 , ISSN : 2671-3268 (Print), ISSN: 2671-3276 (Online), 2022
16. Gëzim Xhambazi, Makfirete Ameti, **Lulzim Mehmedi**: Problem-based learning as a model in creative learning, Education, Vol. 3 | No. 5-6, 2020, ISSN: 2671-3268 (Print), ISSN: 2671-3276 (Online), 2021

3. Pjesëmarrje në Konferenca shkencore

Kandidati Prof. dr. Lulzim Mehmedi ka marrë pjesë në këto konferenca shkencore me prezantime dhe publikime të abstrakteve (2021-2025):

1. **Lulzim Mehmedi**, Makfirete Ameti, Besa Havziu Ismaili, FORESTING EFFECTIVE SCHOOL-FAMILY COOPERATION TO SUPPORT STUDENT DEVELOPMENT, 6-th International Scientific Conference of the Faculty of Pedagogy – ISCFPE 25, INTERNATIONAL CONGRESS ON HUMAN, SOCIAL SCIENCES AND ARTS, 12-13 November, 2025, University of Tetovo Tetovo, Macedonia.
2. **Lulzim Mehmedi**, The Future of Education Based in Digital Technology, 7-th International Conference on Applied Engineering and Natural Sciences ICAENS 2025, May 15 – 16 in 2025 at Konya/Turkey.
3. **Lulzim Mehmedi**, The impact of direct teacher-student discussion on the development of social and interpersonal skills in classrooms, 1-st International Conference on Pioneer and Academic Research ICPAR 2025, June 13 – 14 in 2025, Konya, Turkey.
4. **Lulzim Mehmedi**, Distinguished Speaker et the: SEVENTH EDUCONFERENCE FOR TEACHERS AND IT EXPERTS, 27 – 28 Sptember, Struga.
5. **Lulzim Mehmedi**, THE FUTURE OF EDUCATION BASED ON DIGITAL TECHNOLOGY, 7-th International Conference on Applied Engineering and Natural Sciences ICAENS 2025, May 15 – 16 in 2025, at Konya/Turkey.
6. **Lulzim Mehmedi**, Pjesëmarrës në: Konferenca e Tetë për Shëndetin, Mirëqenien, Edukimin dhe të Drejtat e Fëmijëve më 30 Maj dhe 31 Maj 2025, QHPSM, Prishtinë.
7. **Lulzim Mehmedi**, THE SCHOOL PRINCIPAL AS A LEADER AND MANAGER OF PEDAGOGICAL ACTIVITIES IN SCHOOL, 7-th INTERNATIONAL CONGRESS ON SOCIAL, HUMANITIES, ADMINISTRATIVE, AND EDUCATIONAL SCIENCES IN A CHANGING WORLD, 04-06 October 2025, Urgench, Uzbekistan.
8. **Lulzim Mehmedi**, Lidershipi arsimor dhe roli i tij në menaxhimin e suksesshëm të shkollës, EDUCATION IN A GLOBALIZED ERA: CHALLENGES AND OPPORTUNITIES FOR TRANSFORMATIVE TEACHING AND LEARNING, at the: Kosova International Conference on Educational Research – KICER, 26-27th June, 2025, University of Prishtina.
9. **Lulzim Mehmedi**, Besa Havziu Ismaili, Makfirete Ameti, THE IMPACT OF SCHOOL MANAGEMENT ON TEACHER JOB SATISFACTION: A COMPREHENSIVE STUDY, 5th INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE OF THE FACULTY OF PEDAGOGY (ISCFPE 24), 6-8 November 2024, University of Tetova.
10. **Lulzim Mehmedi**, Besa Havziu Ismaili, Makfirete Ameti, THE IMPACT OF THE PRINCIPALS LEADERSHIP STYLE IN TEACHERS PERFORMANCE ON THE PRIMARY EDUCATION, 4th INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE OF THE FACULTY OF PEDAGOGY (ISCFPE 23), 6-8 November 2024, University of Tetova.
11. **Lulzim Mehmedi**, Pjesëmarrës në: Computing Power Goes Conference, 7 June 2023, Skopje, Republic of North Macedonia.
12. Dean Iliev, **Lulzim Mehmedi**, With Action Research Toward Inclusive Schools, 6th Primary Colors of Education Conference: Nuturing School Leadership-Empowering Equity, 16th-18th October, 2022, Opatija, Croatia.

13. **Lulzim Mehmedi**, pjesëmarrës në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore: „Arsimimi i personave me pengesa - situata aktuale dhe perspektivat”, 13-15 tetor, 2022, Shkup.

14. **Lulzim Mehmedi**, Makfirete Ameti, THE PRINCIPAL AS CREATOR OF THE SCHOOL CLIMATE, 3-RD INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE OF THE FACULTY OF PEDAGOGY (ISCFPE 22), 16 - 18 November 2022, University of Tetova.

15. **Lulzim Mehmedi**, Transforming Higher Education with a focus on Social entrepreneurship & Diversity and inclusion, in the: Capacity Development Support (CDS) Awareness Raising and Training event, 30 – 31 March, 2022: AURORA, Erasmus+ Programme of the European Union.

4. Të dhëna për veprimtarinë profesionale – aplikative (2021-2025)

Në kuadër të veprimtarisë profesionale-aplikative kandidati ka kontribuar në mënyrë aktive si ekspert në një sërë komisionesh dhe aktiviteteve, duke sjellë vlera të rëndësishme në fushën e Pedagogjisë, edhe atë:

- Kryetari komisionit për përgatitjen e elaboratit të programit studimor të ciklit të dytë: Pedagogji, drejtimi: Menaxhimi në arsim (vendimi nr.24-1815/1, data: 20.11.2025)

Kandidati po ashtu shënon pjesëmarrje në aktivitete promovuese të Fakultetit Pedagogjik dhe të Universitetit të Tetovës:

- Ditët e hapura, USHT, prezantim i programit studimor Pedagogji, 2021/22 (vërtetimi nr. 02-1883-2, data 19.11.2025).
- Ditët e hapura, USHT, prezantim i programit studimor Pedagogji, 2022/23 (vërtetimi nr. 02-1883-2, data 19.11.2025)
- Ditët e hapura, USHT, prezantim i programit studimor Pedagogji, 2023/24 (vërtetimi nr. 02-1883-2, data 19.11.2025).
- Ditët e hapura, USHT, prezantim i programit studimor Pedagogji, 2024/25 (vërtetimi nr. 02-1883-2, data 19.11.2025).
- “PërkUSHToju së ardhmes” - promovimi i programeve studimore të UT-së para maturantëve në shkollat e mesme të vendit, 2021 (vërtetimi 02-1883-2, data 19.11.2025).
- “PërkUSHToju së ardhmes” - promovimi i programeve studimore të UT-së para maturantëve në shkollat e mesme të vendit, 2022 (vërtetimi nr. 02-1883-2, data 19.11.2025).
- “PërkUSHToju së ardhmes” - promovimi i programeve studimore të UT-së para maturantëve në shkollat e mesme të vendit, 2023 (vërtetimi nr. 02-1883-2, data 19.11.2025).
- “PërkUSHToju së ardhmes” - promovimi i programeve studimore të UT-së para maturantëve në shkollat e mesme të vendit, 2024 (vërtetimi nr. 02-1883-2, data 19.11.2025).
- Organizimi dhe realizimi i Javës së veçantë studimore me studentët e Fakultetit Pedagogjik, JVS 2022 në temë: Takimi, ndërveprimi, komunikimi dhe reflektimi. (certifikatë)
- Organizimi dhe realizimi i Javës së veçantë studimore me studentët e Fakultetit Pedagogjik, JVS 2023 në temë: Diversiteti natyror dhe kulturor i një pjese të malësisë së Sharrit në komunën e Tetovës. (certifikatë)
- Organizimi dhe realizimi i Javës së veçantë studimore me studentët e Fakultetit Pedagogjik, JVS 2024 në temë: Diversiteti natyror dhe kulturor i një pjese të malësisë së Sharrit në komunën e Bogovinës. (certifikatë)
- Organizimi dhe realizimi i Javës së veçantë studimore me studentët e Fakultetit Pedagogjik, JVS 2025 në temë: Nga ideja në sukses - Menaxhimi efektiv i projekteve. (certifikatë)

Kandidati me vendim të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit përzgjedhet si anëtar i ekipit profesional për hartimin e programeve të reja mësimore nga klasa I-V të arsimit fillor nëntëvjeçar në lëndën Shkencat Natyrore (Vendimi nga BZHA nr. 02-213/1 të datës 29.03.2021).

5. Të dhëna për veprimtarinë me interes më të gjerë (2021 - 2025)

Prof. Dr. Lulzim Mehmedi nga viti 2022 është Kryeredaktor i Revistës ndërkombëtare shkencore Education - *Journal of Educational Research*, Faculty of Pedagogy, University of Tetova, ISSN 2671-3268 (print).

Anëtar i bordit redaktues të revistës ndërkombëtare shkencore Transnational Academic Journal of Economics, e-ISSN: 3023-6924. (The journal is licensed under a [Attribution 4.0 International \(CC BY 4.0\)](#))

Anëtar i bordit ndërkombëtar redaktues të revistës ndërkombëtare shkencore Centrum, ISSN: 1857-8640 (printed version) ISSN: 1857-9396 (online version) UDC: 3 (497.7:4-672EU).

Gjithashtu ka marrë pjesë në bordin organizativ të disa konferencave shkencore me karakter ndërkombëtar siç janë:

1. International Scientific Conference: 75-th Anniversary of the Institute of Pedagogy - Educational Challenges and Future Prospects, Ohrid, 16-18 May 2022, Institut of Pedagogy, Faculty of Filozofy, Skopje.

Ai mori pjesë gjithashtu në komitetin organizues të disa konferencave shkencore ndërkombëtare, si p.sh.

1. 6 th International Scientific Conference of the Faculty of Pedagogy – ISCFPH, INTERNATIONAL CONGRESS ON HUMAN, SOCIAL SCIENCES AND ARTS, 12-13 November, 2025, University of Tetovo-Tetovo, Macedonia.
2. 5 th International Scientific Conference of the Faculty of Pedagogy – ISCFPH, INTERNATIONAL CONGRESS ON HUMAN, SOCIAL SCIENCES AND ARTS, 06-08 November, 2024, University of Tetovo-Tetovo, Macedonia.
3. 4 th International Scientific Conference of the Faculty of Pedagogy – ISCFPH, INTERNATIONAL CONGRESS ON HUMAN, SOCIAL SCIENCES AND ARTS, 15-17 November, 2023, University of Tetovo-Tetovo, Macedonia.
4. 3 th International Scientific Conference of the Faculty of Pedagogy – ISCFPH, INTERNATIONAL CONGRESS ON HUMAN, SOCIAL SCIENCES AND ARTS, 16-18 November 2022, University of Tetovo, Macedonia.

Nga viti 2021 ka qenë bartës i disa funksioneve të rëndësishme siç janë:

- Anëtar i Komisionit për dhënien e provimit për shkollat fillore, shkollat e mesme dhe universiteteve publike të qytetarëve për mësim gjatë tërë jetës (Vendimi nr. 02-484/1 të datës 20.11.2024)
- Anëtar i Komisionit për hartimin e programeve të reja mësimore nga kl.I-V të arsimit fillor nëntëvjeçar në lëndën Shkencat Natyrore (Vendimi nr.02-213/1 të dt. 29.03.2021);

- Anëtar i Këshillit drejtues për ndjekjen e projektit “Përmirësimi i cilësisë në arsim” - NEAR/SKP/2021/EA-RP/0053 (Vendimi nr. 11-548/1 të datës 14.01.2022)
- Anëtar i Grupit konsultues-punues në kuadër të Projektit për përmirësimin e shërbimeve sociale (Vendimi nr. 10-8279/1 të datës 19.12.2024)
- Anëtar i Senatit të Universitetit të Tetovës i zgjedhur nga Fakulteti Pedagogjik (20.05.2021-27.05.2022);
- Zëvendësanëtar i Education Policy Advisors Network (EPAN) në kuadër të Komisionit për Arsimit të Këshillit të Europës, si përfaqësues i Maqedonisë së Veriut.

Ndërsa nga 27.05.2025 është Dekan i Fakultetit Pedagogjik, Universiteti i Tetovës (Vendim për vërtetimin e vendimit të zgjedhjes së Dekanit të Fakultetit Pedagogjik 02-675/1 të datës 06.05.2025);

Gjithashtu ka marrë pjesë në këto komisione recensuese për zgjedhje-rizgjedhje në thirrje mësimore-shkencore:

- Zgjedhje - rizgjedhje të dy mësimdhënësve në thirrje të titulluar docent/profesor inordinar lëmin e Arsimit elementar (50507 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjëve shkencor-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) (Vendimi për formimin e Komisionit recensues me nr. 24-1274/1 të datës 24.11.2022 të Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Pedagogjik)
- Zgjedhje - rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëminë e Teorisë së edukatës, Arsimit të mësimdhënësve dhe tjera (50505, 50513 dhe 50525 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjëve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) (Vendimi për formimin e Komisionit recensues me nr. 24-410/1 të datës 02.05.2024 i Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Pedagogjik)
- Zgjedhje - rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëminë Metodika e artit figurativ dhe të tjera (60708 dhe 60712 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjëve shkencor-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) (Vendimi për formimin e Komisionit recensues nr.24-1443/1 të datës 21.12.2022 i Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Pedagogjik)

Kandidati Prof. dr. Lulzim Mehmedi ka marrë pjesë edhe në këto trajnime dhe seminare profesionale me karakter ndërkombëtar:

1. “2023 European Quality Assurance Forum hosted by the University of Aveiro, Portugal, prej 23-25.11.2023.
2. Pjesëmarrës në trajnimin “A pandemic reality check - Preparing schools for the new normal learning environment” në Institutin Nacional të Edukimit në Singapor, prej 12-15.07.2022. (Confirmation Letter dhe Certifikatë për pjesëmarrje);
3. Pjesëmarrës në Trajnimin “Towards Practices and Positives Behavior Support in Education and Social Work Countries Reports - Project ID: 22330002, prej 08-12.09.2025 (Certifikatë për pjesëmarrje)
4. Pjesëmarrës në takimin e 14-të vjetor të EPAN në Komisionin për arsim të Këshillit të Europës në Strazburg, Francë, 20-21.05.2025. (Ftesa e datës 26.02.2025)

Prof.dr. Lulzim Mehmedi ka realizu edhe recenzion të tekstit me titull “Profesionalizimi i profesionit të mësimdhënësit të arsimit sipëror (perspektiva didaktike) të autorëve prof.dr. Dean Iliev, prof.dr. Tatjana Atanasova-Paçemska dhe Borço Aleksov. (recenzioni dhe kontrata në vepër nënshkruar me Ministrinë e arsimit të Kroacisë).

Gjithashtu ka qenë i angazhuar edhe te Byroja për Zhvillim Regjional në Shkup si dhënës i shërbimeve të jashtme për monitorimin e progresit të projektit “Computering power goes green-go-green” (Kontrata numër 16-6/1, të datës 21.12.2022)

Kandidati në fjalë bashkë me fletaplikimin 04-02-24 të datës 17.11.2025 ka dorëzuar edhe:

- Vendimin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore Profesor inordinar;
- Diplomë për gradën shkencore Doktor i shkencave nga fusha e Menaxhimit në arsim nga Fakulteti Filozofik, Universiteti Shën Kirili dhe Metodi - Shkup;
- Biografi e shkurtër;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara (2021-2025);
- Kopje të certifikatave nga pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare (2021-2025);
- Punimin të doktoraturës;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë;
- Vërtetimin për njohjen e gjuhës angleze.
- Certifikata, vendime, konfirmime të pjesëmarrjes në komisione, aktivitete dhe projekte;

PROPOZIM - VENDIM

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatit, duke u mbështetur në vlerësimet e paraqitura në këtë raport, si dhe duke marrë për bazë mbindërtimin dhe përvojën profesionale të kandidatit, ka nderin që Këshillit mësimor - shkencor të Fakultetit Pedagogjik, t'i propozojë që **Prof. dr. Lulzim Mehmedi** të zgjidhet **Profesor ordinar** në lëmin **Menaxhimi në arsim dhe Didaktikë** (5.03.00.07, 5.03.00.02 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit);

Komisioni recensues vlerëson se kandidati në fjalë ka kualitete shkencore dhe profesionale, i plotëson të gjitha kriteret e parapara me Ligjin për arsim të lartë, Statutin e Universitetit të Tetovës, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore dhe thirrje të bashkëpunorëve, si dhe aktet e tjera normative, për t'u zgjedhur në këtë thirrje mësimore-shkencore.

Tetovë, 25.11.2025

Anëtarët e Komisionit recensues:

Prof. Dr. Fadbi Osmani (kryetar)

Prof. Dr. Dobri Petrovski (anëtar)

Prof. Dr. Metodija Stojanovski (anëtar)

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TUTULL MËSIMOR-SHKENCOR – PROFESOR ORDINAR

Kandidati: Lulzim Shaqet Mehmedi

Institucioni: Fakulteti Pedagogjik – UT, Tetovë

Lëmi shkencor: Menaxhimi në arsim dhe Didaktikë (5.03.00.07, 5.03.00.02 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit);

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Suksesi mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe ciklit të dytë, për secilin cikël veçmas, përkatësisht ka arritur sukses mesatar së paku 8,00 (tetë) në studimet e integruara në ciklin e parë dhe të dytë Suksesi mesatar në ciklin e parë: 10.00 Suksesi mesatar në ciklin e dytë: 10.00	Po
2	Titull shkencor – doktor i shkencave nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet Emri i sferës shkencore: Menaxhimi në arsim dhe Didaktikë Doktor në Menaxhimin në arsim (Diplomë doktorate, Universiteti Shën Kirili dhe Metodi-Shkup, nr. i diplomës: 4221, 07.02.2017)	Po
3	Të ketë të publikuara së paku 6 (gjashtë) punime shkencore të recensuara* në publikime shkencore referente në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje	Po
3.1	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensionit dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër e revistave të cilën do ta përcaktojë Këshilli kombëtar për arsimin e lartë: 1. Emri i revistës shkencore: Pakistan Journal of Life and Social Sciences, ISSN: 17274915, 22216730 E-ISSN: 2221-7630. 2. Emri i bazës elektronike të revistave: https://doi.org/10.57239/PJLSS-2025-23.1.00547 , Web Of Science, Scopus 3. Titulli i punimit: „The Reflective Teacher and the Social Competences of Students in North Macedonia“ 4. Data e publikimit: 2025 1. Emri i revistës shkencore: Education Journal of Educational Research, ISSN (Print): 2671-3268, ISSN (Online): 2671-3276, Vol. 7 No. 13-14, 2. Emri i bazës elektronike të revistave: Google Scholar, Index Copernicus International, CEEOL, EBSCO, CROSSREF, ISI Impact Factor (IIF) = 0.0699 3. Titulli i punimit: „The impact of shcool management on teacher job satisfaction: a comprehensive study 4. Data e publikimit: 2025	Po

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
	1. Emri i revistës shkencore: FREEDOM Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication, Vol. 3, No. 5-6, 2022, 2. Emri i bazës elektronike të revistave: EBSCO, Google Scholar, Index Copernicus International, CEEOL, CROSSREF 3. Titulli i punimit: „Integration of foreigners within the boundaries of the European Union: National States and Citizenship” 4. Data e publikimit: 2022 1. Emri i revistës shkencore: Education Journal of Educational Research, ISSN (Print): 2671-3268, ISSN (Online): 2671-3276, Vol. 6 No. 11-12, 2. Emri i bazës elektronike të revistave: Google Scholar, Index Copernicus International, CEEOL, EBSCO, CROSSREF, ISI Impact Factor (IIF) = 0.0699 3. Titulli i punimit: “The impact of the principals leadership style in teacher performance on the primary education” 4. Data e publikimit: 2024 1. Emri i revistës shkencore: Education Journal of Educational Research, ISSN (Print): 2671-3268, ISSN (Online): 2671-3276, Vol. 6 No. 11-12, 2. Emri i bazës elektronike të revistave: Google Scholar, Index Copernicus International, CEEOL, EBSCO, CROSSREF, ISI Impact Factor (IIF) = 0.0699 3. Titulli i punimit: “Effective management of changes in primary schools” 4. Data e publikimit: 2024 1. Emri i revistës shkencore: International Journal of Cognitive Research in Science, Engineering and Education 2. Emri i bazës elektronike të revistave: Emerging Sources Citation (Web of Science), WoS Clarivate Analytics, 2024 Impact Factor - 0.7, Q3 in Education-Educational Research Scopus. 3. Titulli i punimit: “Learning Through Games and Its Impact on the Development of Student’s Knowledge During the Pandemic Period” 4. Data e publikimit: 2023 1. Emri i revistës shkencore: Scientific Herald of Uzhhorod University 2. Emri i bazës elektronike të revistave: Scopus, OCLC World Cat, Open AIRE, Crossref Event Data, BASE Bielefeld Academic Search Engine, Google Scholar, Professional publication of Ukraine, VNLU. 3. Titulli i punimit: “The Role of the Director in the Process of Evaluating School Performance, Pegem Journal of Education and Instruction” 4. Data e publikimit: 2024 1. Emri i revistës shkencore: Scientific Herald of Uzhhorod University 2. Emri i bazës elektronike të revistave: Scopus, OCLC World Cat, Open AIRE, Crossref Event Data, BASE Bielefeld Academic Search Engine, Google Scholar, Professional publication of Ukraine, VNLU. 3. Titulli i punimit: “Key historical periods in the development of music pedagogy: Analysis and overview” 4. Data e publikimit: 2024 1. Emri i revistës shkencore: Pegem Journal of Education and Instruction 2. Emri i bazës elektronike të revistave: Scopus, Index Copernicus, Indexed in	

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
	Thomson Reuters-Emerging Sources Citation, ERIC Institute of Education Sciences, Tubitak ULAKBIM, ProQuest. 3. Titulli i punimit: “The Role of the Director in the Process of Evaluating School Performance” 4. Data e publikimit: 2024 1. Emri i revistës shkencore: Education Journal of Educational Research, ISSN (Print): 2671-3268, ISSN (Online): 2671-3276, Vol. 5 No. 9-10, 2. Emri i bazës elektronike të revistave: Google Scholar, Index Copernicus International, CEEOL, EBSCO, CROSSREF, ISI Impact Factor (IIF) = 0.0699 3. Titulli i punimit: “The effects of evaluation of the Special Study Week/SSW 2022 – a case study of the Faculty of Pedagogy at University of Tetova” 4. Data e publikimit: 2023 1. Emri i revistës shkencore: Education Journal of Educational Research, ISSN (Print): 2671-3268, ISSN (Online): 2671-3276, Vol. 5 No. 9-10, 2. Emri i bazës elektronike të revistave: Google Scholar, Index Copernicus International, CEEOL, EBSCO, CROSSREF, ISI Impact Factor (IIF) = 0.0699 3. Titulli i punimit: “Forms and methods of school - family cooperation” 4. Data e publikimit: 2022 1. Emri i revistës shkencore: Education Journal of Educational Research, ISSN (Print): 2671-3268, ISSN (Online): 2671-3276, Vol. 4 No. 7-8, 2. Emri i bazës elektronike të revistave: Google Scholar, Index Copernicus International, CEEOL, EBSCO, CROSSREF, ISI Impact Factor (IIF) = 0.0699 3. Titulli i punimit: “Problem-based learning as a model in creative learning” 4. Data e publikimit: 2021 1. Emri i revistës shkencore: Philosophica International Journal of Social and Human Sciences, ISSN (Shtyp): 1857-9272, ISSN (Online): 2671-3020, Vëll. 12 Nr. 24-25, 2. Emri i bazës së të dhënave elektronike të revistave: Google Scholar, Index Copernicus International, CEEOL, ERIHPLUS, EBSCO, CROSSREF, ISI Impact Factor(IIF)=0.028 3. Titulli i punimit: “Koncepti 'intelektual' në strukturën shoqërore postmoderne: 'intelektuali specifik' i Michel Foucault dhe 'interpretuesit' e Zygmunt Bauman 4. Data e publikimit: 2025 1. Emri i revistës shkencore: FREEDOM Journal for Peace Building and Transcultural Communication, Vol. 4, Nr. 7-8, 2023, 2. Emri i bazës së të dhënave elektronike të revistave: EBSCO, Google Scholar, Index Copernicus International, CEEOL, CROSSREF 3. Titulli i punimit: “I Lirë: Ardhja e Pjekurisë në Fund të Historisë, Recension i Themeluar i “I Lirë” nga Lea Ypi” 4. Data e publikimit: 2023 1. Emri i revistës shkencore: Philosophica: Philosophica International Journal of Social and Human Sciences, ISSN (Shtyp): 1857-9272, ISSN (Online): 2671-3020, Vol.8 / Nr. 15-16 / (2021), 2. Emri i bazës së të dhënave elektronike të revistave: Google Scholar, Index Copernicus International, CEEOL, ERIHPLUS, EBSCO, CROSSREF, ISI Impact	

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
	Factor(IIF)=0.028 3. Titulli i punimit: Përcaktimi i fazave të zhvillimit moral të Kohlbergut dhe moshës kronologjike, 4. Data e publikimit: 2021 1. Emri i revistës shkencore: FREEDOM Journal for Peace Building and Transcultural Communication, 2. Emri i bazës së të dhënave elektronike të revistave: EBSCO, Google Scholar, Index Copernicus International, CEEOL, CROSSREF 3. Titulli i punimit: “Ideali i Kantit për botën” Republika dhe Paqja e Përjetshme, 4. Data e publikimit: 2021 1. Emri i revistës shkencore: Clío: Journal of History, Human Sciences and Critical Thinking 2. Emri i bazës së të dhënave elektronike të revistave: Scopus, SCImago Journal&Country Rang, Pubindex, ROAD, Latindex, DOAJ, BASE, CRUE, Mir@bel, EuroPub, Scope Database, MIAR, CORE, Revencyt, Copernicus, SUDOC, Latin REV, Directory of Research Journal Indexing, Google Academico, Portal de Hispansimo, Consejo Superior de Investigaciones Cientificas 3. Titulli i punimit: Marrëdhënia midis Arkeologjisë, Historisë së Ideve dhe Gjenealogjisë në Filozofinë e Michel Foucault 4. Data e publikimit: 2025/26	
3.2	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensionit dhe e cila ka këshill redaktues ndërkombëtar në të cilin marrin pjesë anëtarë nga së paku tre shtete, me ç’rast numri i anëtarëve nga një shtet nuk mund t’i tejkalojë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve. 1. Emri i revistës shkencore: Education Journal of Educational Research, ISSN (Print): 2671-3268, ISSN (Online): 2671-3276, Vol. 5 No. 9-10. 2. Emri i bazës elektronike të revistave: Google Scholar, Index Copernicus International, CEEOL, EBSCO, CROSSREF, ISI Impact Factor (IIF) = 0.0699 3. Titulli i punimit: “The teacher’s professional ethic, a factor that affects the success of the student’s achievements” 4. Data e publikimit: 2023 1. Emri i revistës shkencore: Pioneer and academic studies in Educational Sciences 2. Emri i bazës elektronike të revistave: 3. Titulli i punimit: “The impact of direct teacher-student discussion on the development of social and interpersonal skills in classroom” 4. Data e publikimit: 2025	Po
3.3	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensionit dhe e cila është publikuar në shtetin anëtar të Bashkimit Evropian/ose OBZHE 1. Titulli i revistës shkencore: _____ 2. Emri i shtetit anëtar i BE/OBZHE _____	Jo

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
	3. Titulli i punimit: _____ 4. Data e publikimit: _____	
3.4	Libri ose pjesa e librit të recensuar dhe publikuar në shtetin anëtar i Bashkimit Evropian/ose OBZHE 1. Titulli i librit: _____ 2. Emri i shtetit anëtar i BE/ose OBZHE _____ 3. Botuesi, viti dhe vendi i botimit/publikimit: _____	Jo
3.5	Përmbledhja e punimeve shkencore të recensuara, të prezantuara në tubime shkencore ndërkombëtare ku anëtarët e programit ose këshillit shkencor janë nga së paku tre shtete. 1. Titulli i përmbledhjes: Education in a Globalized Era: Challenges and Opportunities for Transformative Teaching and Learning, Kosova International Conference on Educational Research-KICER 26-27-th of June, 2025 2. Emrat e shteteve: Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Turqia. 3. Titulli i punimit: “Lidershipi arsimor dhe roli i tij në menaxhimin e suksesshëm të shkollës” 4. Data e publikimit: 2025 1. Titulli i përmbledhjes: Qendra për Hulumtime Psiko-Sociale dhe Mjekësore. Konferenca Ndërkombëtare për Shëndetin, Mirëqenien, Edukimin dhe të Drejtat e Fëmijëve 2. Emrat e shteteve: Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Turqia. 3. Titulli i punimit: “Qasjet dhe vështirësitë e mësimdhënësve në punën me nxënës me nevoja të veçanta në arsimin fillor - sfidat dhe mundësitë në Maqedoninë e Veriut” 4. Data e publikimit: 2025 1. Titulli i përmbledhjes:”, Filozofija Islama. Zbornik radova sa 28. simpozija, Islamska zajednica u Hrvatskoj, Zagreb, 2024. (ISBN: 978-953-6330-70-6), 2. Emri i tubimit shkencor ndërkombëtar: Filozofija Islama 3. Emrat e shteteve: Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Srbija, Maqedonia e Veriut 4. Titulli i punimit: „Sufijska epistemologija i duhovno iskustvo u duhovnoj tradiciji 5. Data e publikimit: 2025	Po
3.6	Përkthime të veprave kapitale në fushat që i përcakton Këshilli kombëtar i arsimit të lartë dhe veprimtaria kërkimore-shkencore 1. Titulli i veprës kapitale të përkthyer: _____ 2. Data e publikimit: _____ 3. Botuesi, vendi dhe viti i botimit: _____	Jo
4	Libër mësimor i recensuar dhe publikuar, monografi, praktikum ose përmbledhje detyrash nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet** 1. Titulli i librit mësimor, monografisë, praktikumit ose përmbledhjes së detyrave: “Mjedisi i sigurt shkollor në kurrikulat e Fakulteteve Pedagogjike-modul me zgjedhje teorike dhe praktike”, COBISS.MK-ID 66331397 2. Vendi dhe data e botimit: Arbëria Design, Tetovë 2025	Po
5	Zgjedhja e mëparshme në titullin mësimor-shkencor – profesor i asociuar, data dhe numri i Buletinit: 14.04.2021-28.04.2021, nr. 185 https://unite.edu.mk/wp-content/uploads/2021/04/Fakulteti-Pedagogjik.pdf	Po

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
6	Posedon aftësi për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë Emri i institucionit ku janë fituar aftësitë dhe shkathtësitë për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë: Universiteti i Tetovës, Fakulteti Pedagogjik Lloji i trajnimit/ përvoja/ arsimimi për fitimin e aftësive dhe shkathtësive për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë Përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë që nga viti 2010 Periudha e fitimit të aftësive dhe shkathtësive për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë: 2010-2025	Po

FORMULARI 2

PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: Lulzim Shaqet Mehmedi

Institucioni: Fakulteti Pedagogjik – UT, Tetovë

Lëmi shkencor: Menaxhimi në arsim dhe Didaktikë (5.03.00.07, 5.03.00.02 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit);

VEPRIMTARIA EDUKATIVE-MËSIMORE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikët
1.	Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e parë të studimeve)	33.6
1.1.	Menaxhimi në arsim (Pedagogji Profesionale)	2x15x0.04x4=4.8
1.2	Menaxhimi në arsim (Mësim Klasor, Edukim Parashkollor)	2x15x0.04x4=4.8
1.3	Bashkëpunimi i shkollës me institucionet edukative (Mësim Klasor, Edukim Parashkollor)	2x15x0.04x4=4.8
1.4	TIK-u në mësimdhënie (Mësim Klasor, Pedagogji Profesionale, Edukim Parashkollor)	2x15x0.04x4=4.8
1.5	Pedagogji me Didaktikë (FSHMN-Matematikë, Fizikë, Kimi, Informatikë, Gjeografi, Drejtimet arsimore)	2x15x0.04x4=4.8
1.6	Pedagogji me Didaktikë (FSHMN-Biologji drejtimi arsimor)	2x15x0.04x4=4.8
1.7	Pedagogji (Pedagogji profesional, ESR, Logopedi)	2x15x0.04x4=4.8
2	Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e dytë të studimeve)	36,00
2.1	Metodologjia e hulumtimeve pedagogjike (Pedagogji, drejtimi: Menaxhimi në arsim)	3x15x4x0.05=9
2.2	Udhëheqja me shkollën (Pedagogji, drejtimi: Menaxhimi në arsim)	3x15x4x0.05=9
2.3	Ndërmarrësia në arsim (Pedagogji, drejtimi: Inovacionet në mësim)	3x15x4x0.05=9
2.4	Pedagogji me Didaktikë (Fizikë, drejtimi: Arsimor)	3x15x4x0.05=9
4	Mësimdhënie në shkolla dhe punëtori	34.5
4.1	“Arsimi në kontekst bashkëkohor: Zhvillimi i shkathtësive socio-emocionale”, SHF “Sande Shterjoski”-Kërçovë, 18-19.06.2024, Universiteti i Tetovës (raport nga trajnimi dhe vërtetim)	1,5
4.2	“Arsimi në kontekst bashkëkohor: Zhvillimi i shkathtësive socio-emocionale”, SHF “Nuri Mazari”-Dellogozhdë, 20-21.06.2024, Universiteti i Tetovës (raport nga trajnimi dhe vërtetim)	1.5
4.3	“Arsimi në kontekst bashkëkohor: Zhvillimi i shkathtësive socio-emocionale”, SHF “Orhan Xhemali”-Tatesh i Epërm, 20-21.06.2024, Universiteti i Tetovës (raport nga trajnimi dhe vërtetim)	1.5
4.4	“Arsimi në kontekst bashkëkohor: Zhvillimi i shkathtësive socio-emocionale”, SHF “Bratstvo”-Ohër, 08-09.07.2024, Universiteti i Tetovës (raport nga trajnimi dhe vërtetim)	1.5
